UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 34, datë 29.12.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI

(Ndryshuar me udhëzim të përbashkët nr. 136/3, datë 15.2.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", ministri i Financave dhe ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZOJNË:

1. Tarifa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtimin e automjeteve është si më poshtë:
a) për lejedrejtimi të kategorisë AM, A1, A2, A 3000 (tre mijë) lekë;
b) për lejedrejtimi të kategorisë B1, B
4500 (katërmijë e pesëqind) lekë;
c) për lejedrejtimi të kategorisë C1, C
2000 (dy mijë) lekë;
ç) për lejedrejtimi të kategorisë D1, D
3000 (tremijë) lekë;
d) për lejedrejtimi të kategorive B96, BE, C1E, CE, D1E, DE
3000 (tre mijë) lekë

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor caktohet agjent për mbledhjen e tarifës të pajisjes me leje drejtimi.

3. Shtetasit që pajisen me leje drejtimi paguajnë tarifën në momentin e dhënies së dëshmisë së aftësisë për drejtim automjeti.

4. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj tarife. Të gjitha pagesat e tarifës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas shtojcës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në cilësinë e agjentit të mbledhjes të kësaj tarife është i detyruar;

a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklarimet.

b) të paguaj për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

Për pagesën me vonesë të shumave të arkëtuara nga tarifa për agjentin zbatohen sanksione sipas dispozitave të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Për shkeljet sipas përcaktimeve të nenit 117 të ligjit " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", për agjentin e tarifës zbatohen sanksionet e përcaktuara në këtë nen.

c) Deklarata, bëhet në përputhje me modelin bashkëlidhur udhëzimit të ministrit të Financave, nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar. Deklarata plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga DPSHTRR nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. DPSHTRR-ja duhet të dorëzojë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifat.

Mosdeklarimi brenda datës 15 të muajit pasardhës, i çdo periudhe tatimore nga agjenti i tarifës kombëtare, ndëshkohet me gjobë për mosdeklarim sipas dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

6. Për shërbimin e kryer, DPSHTRR-ja mban 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 95% të shumës së arkëtuar.

DPSHTRR-ja vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit të përcaktuar me këtë udhëzim të përbashkët me vlerën e arkëtimeve nga tarifat për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton, si dhe deklaron dhe paguan në llogari të

Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

7. Udhëzimi nr. 34, datë 27.10.2008, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për pajisjen me lejedrejtimi", shfuqizohet.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

MINISTËR I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

SHTOJCA NR. 1
REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË PAJISJES ME LEJEDREJTIMI PËR DREJTIM AUTOMJETI

Nr.	Emër,mbiemër	Lloji i lejes së	Masa e	Nr. i

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor